

V E N D I M
Nr. 285, datë 27.6.2002

PËR TARIFAT E SHËRBIMEVE QË KRYEN POLICIA E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT NDAJ SHTETASVE DHE PERSONAVE, JURIDIKË E FIZIKË, VENDAS E TË HUAJ

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2/b dhe 3 të nenit 17, e pikës 2 të nenit 20 të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Tarifat e shërbimeve, që kryen Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj, janë si më poshtë vijon:

1. Për kundërfirmimin e studimeve urbanistike, të planeve rregulluese, projekteve të shesheve të të ndërtimit dhe të objekteve brenda tyre, sipas përcaktimit të nenit 30 të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin", tarifat përcaktohen:

1.1. Për projektet e mbrojtjes nga zjarri, që u bëhen studimeve urbanistike dhe planeve rregulluese, tarifa të jetë 0.5 për qind e vlerës së projektit.

1.2. Për banesat, rikonstruksionet e tyre e shtesë kati në to, si dhe për çdo lloj objekti ndërtimi, me vlerë deri në 1 000 000 lekë, tarifa të jetë 500 (pesëqind) lekë.

1.3. Për banesat, dyqanet, lokalet, serviset, repartet artizanale, magazina mallrash etj., me vlerë investimi nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë, tarifa të jetë 1 000 (një mijë) lekë.

1.4. Për hotelet, motelet, rezidencat, komplekse dyqanesh ose supermarkete me vlerë investimi deri në 20 000 000 lekë, tarifa të jetë 5 000 (pesë mijë) lekë.

1.5. Për objektet me vlerë investimi deri në 50 000 000 lekë, tarifa të jetë 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

1.6. Për objektet me vlerë investimi mbi 50 000 000 lekë, tarifa të jetë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

1.7. Për ndërtime qyteza e fshatra turistike, si dhe për vepra të tjera me vlerë investimi mbi 1 000 000 USD, tarifa të jetë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

2. Për objektet me rrezik të theksuar për rënie zjarri e shpërthimi

2.1. Për fabrikat, uzinat e qendrat e përpunimit të naftës e gazit të lëngëzuar, fabrikat e polisterolit e për prodhime kimikatesh, si dhe për vepra e objekte me proces teknologjik me rrezik zjarri të kategorive "A" dhe "B" (përcaktuar me rregulloren e projektimit të ndërtesave të çdo lloji), tarifa të jetë 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

2.2. Për depo qëndrore karburanti, pika të shitjes së karburanteve dhe impianti të depozitimit dhe mbushjes të bombulave me gaz të lëngëzuar, tarifa të jetë 20 000 (njëzet mijë) lekë.

2.3. Për qendra e magazina të depozitimit të gazit të lëngshëm me shumicë, të karburanteve e lubrifikantëve në fuçi, të kimikateve e lëndëve të tjera me rrezik zjarri, tarifa të jetë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

2.4. Për projekte të shfrytëzimit të burimeve të naftës, puse të shpim-kërkimit për tubacionet magjistrale të transportimit dhe për të gjithë infrastrukturën që lidhet me shfrytëzimin e tyre, tarifa të jetë 20 000 (njëzet mijë) lekë.

2.5. Për fabrika mielli, përpunimi druri, përpunimi të bimëve medicinale, të prodhimit të veshjeve dhe objekteve të tjera me proces teknologjik me rrezik zjarri të kategorisë "C", tarifa të jetë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

2.6. Për fabrika e ndërmarrje të përpunimit e prodhimit të produkteve ushqimore, të detergjentëve, të prodhimit kozmetik, të pijeve alkoolike etj. tarifa të jetë 20 000 (njëzet mijë) lekë.

2.7. Për rikonstruksionet që kryen në të gjitha këto objekte, të cilat bëhen në bazë të projekteve përkatëse, tarifa të jetë 5 000 (pesë mijë) lekë.

3. Për kontrollin teknik pas përfundimit të punimeve

3.1. Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, në përfundimin e veprës apo të objektit, kontrollon, harton dhe u jep personave, juridikë e fizikë, shoqërive, private e shtetërore, aktin teknik

përkatës, në mbështetje të nenit 31 të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001, tarifa e të cilit të jetë 5 000 (pesë mijë) lekë.

3.2. Për përdorimin e automjeteve (autobote) që transportojnë karburante, gaze të lëngëzuar, alkooole, kimikate me rrezik zjarri, jepet akti teknik për plotësimin e normave teknike të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, tarifa e të cilit të jetë 1 000 (një mijë) lekë.

3.3. Për ripërtëritjen vjetore të aktit teknik, tarifa të jetë 1 000 (një mijë) lekë.

4. Drejtoria e PMNZSH-së u jep personave juridikë, vendas e të huaj, licencën për prodhimin, mirëmbajtjen dhe tregtimin e teknikës, pajisjeve zjarrfikëse dhe lëndëve për shuarjen e zjarrit, tarifa e së cilës të jetë 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë. Ripërtëritja e licencës bëhet çdo vit, kundrejt tarifës prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh.

5. Për kryerjen e aktekspertizës për zjarret e rëna, kur kërkohet nga organet e prokurorisë, të gjykatës ose nga vetë shtetasit, personat, juridikë e fizikë, vendas e të huaj, tarifa të jetë 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

6. Të gjitha shumat e arkëtuara të derdhen në degët e thesarit për llogari të buxhetit përkatës të prefekturës, nga të cilat 30 për qind i kalojnë Buxhetit të Shtetit dhe 70 për qind përdoren për nevojat e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

7. Të ardhurat që i kalojnë shërbimit të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit të përdoren për mbulimin e shpenzimeve të kryera për realizimin e të ardhurave dhe për financimin e veprimtarive kryesore për shpenzimet operative, rinovimin e automjeteve dhe pajisjeve zjarrfikëse, për investime dhe për shpërblimin e punonjësve.

8. Vendimi nr. 556, datë 10.10.1994 i Këshillit të Ministrave "Për tarifën e shërbimeve që u kryhen personave, juridikë dhe fizikë, nga inspektorati zjarrfikës" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko